



Lajmet e Fundit:

Tiranë – Policia Rrugore vë në pranga një drejtues mjeti në gjendje të dehur, për mitëdhënie No views•Feb 24, 2021



Lajmet

22/02/2021

Shkodër – Zbardhet ngjarja e ndodhur ditën e djeshme, në lagjen “Skënderbeg”, ku disa persona qëlluan me armë në drejtim të automjetit që drejtohej nga shtetasi T. P.

Zbardhet ngjarja e ndodhur ditën e djeshme, në lagjen “Skënderbeg”, ku disa persona qëlluan me armë në drejtim të automjetit që drejtohej nga shtetasi T. P.

Identifikohen dhe shpallen në kërkim autorët e dyshuar të kësaj ngjarjeje.

Strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, pas një pune intensive hetimore për zbardhjen e ngjarjes së ndodhur ditën e djeshme, kanë bërë identifikimin dhe shpalljen në kërkim të autorëve të dyshuar, shtetasit:

Sh. Xh., 29 vjeç, banues në lagjen “Guerile”, Shkodër, i dënuar më parë për veprën penale “Vrasja” e mbetur në tentativë”;

S. Xh., 24 vjeç, banues në lagjen “Guerile”, Shkodër, me precedent të mëparshëm penal;

E. H., 31 vjeç, banues në lagjen Guerile, Shkodër, i dënuar më parë për veprën penale “Vrasja me dashje”.

Këta shtetas, ditën e djeshme, rreth orës 11:50, në lagjen “Skënderbeg”, Shkodër, në afërsi të një pike karburanti, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë qëlluar me armë zjarri pistoletë drejt një automjeti tip “Volkswagen”, me drejtues shtetasin T. P., 30 vjeç dhe pasagjer shtetasin K. M., 46 vjeç.

Nga veprimet hetimore ka rezultuar se ngjarja ka ndodhur si pasojë e një konflikti të mëparshëm midis autorëve të dyshuar dhe shtetasit T. P.

Në cilësinë e provës materiale janë gjetur dhe sekuestruar një mjet tip “Audi” dhe një targë që i përket njërit nga mjetet me të cilin janë larguar autorët e dyshuar.

Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për veprat penale “Vrasje ndaj dy ose më shumë personave” e kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë dhe “Armëmbajtja pa leje”.



Share



Share



Share



Share



Email

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Tiranë – Arrestohen në flagrancë 4 shtetas, për vepra të ndryshme penale

Ndëshkohen me masë administrative 2986 shtetas që nuk zbatuan masat anticovid, gjatë fundjavës ▶